



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVË

Numri i lëndës: 2024:028813

Datë: 05.06.2024

Numri i dokumentit: 05783236

**K.DH.Shk II.nr.750/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbare të “Ymalko Kosova” Sh.P.K., ish Xella Kosova L.L.C, me numër unik identifikues 810593188 dhe me seli në Graçanicë, Gushtericë e Ulët, Magjistratja Prishtinë - Ferizaj, kundër debitorit Kompania Gashi Com N.T.SH, me numër unik identifikues 810304361 dhe me seli në Kaçanik, Begracë, me bazë juridike përmbare, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.838/23 të datës 17.01.2024, me datë **05.06.2024**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e kreditorit “Ymalko Kosova” Sh.P.K., ish Xella Kosova L.L.C, me seli në Graçanicë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 838/23 të datës 17.01.2024, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 838/23 të datës 17.01.2024 në pikën I të dispozitivit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit të Kompania Gashi Com N.T.SH të ushtruar kundër Urdhrit

për Përmbarrim P.nr.201/23 të dt. 28.04.2023 të Përmbarruesit Privat Rrezarta Metaj, dhe i njëjti Urdhër për përmbarrim është anuluar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Ekonomik, KPPP.nr. 838/23 të datës 17.01.2024, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Debitori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë .

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

**Ankesa e të autorizuarit të kreditorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Ymalko Kosova” Sh.P.K., ish Xella Kosova L.L.C me datën 28.04.2023 ka paraqitur propozimin për përmbarrim mbi bazën e dokumentit të besueshëm, ne bazë të, Faturës nr. INV-18-1187, e datës 21.12.2018; Faturës nr. INV-18-1187, e datës 20.12.2018; Faturës nr. INV-18-1185, e datës 21.12.2018; Faturës nr. INV-19-0525, e datës 26.04.2019; Faturës nr. INV-19-0466, e datës 18.04.2019; Faturës nr. INV-19-1045, e datës 17.07.2019; Faturës nr. INV-19-1098, e datës 23.07.2019; Faturës nr. INV-19-1103, e datës 24.07.2019; Faturës nr. INV-19-1127, e datës 26.07.2019; Faturës nr. INV-19-1175, e datës 01.08.2019, ka lejuar Urdhrin Përmbarrimor P.nr. 201/23, të datës 28.04.2023, me të cilin është urdhëruar debitori që kreditorit t’ia paguaj shumën prej EUR 9,192.56, me kamatë ligjore prej 8 %, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, duke kundërshtuar urdhrin përmbarrimor, me arsyetimin se dokumentet në bazë të së cilave është iniciuar procedura përmbarrimore nuk janë paraqitur në origjinal apo kopje të vërtetuar, poashtu nga faturat shihet se debitori ka pasur marrëdhënie kontraktuale me një tjetër biznes siç është “Xella Kosova”

L.L.C, prandaj edhe procedura përmbarimore është iniciuar në kundërshtim me nenin 4, par. 1 të LPP-së. Më tej, ka theksuar se pretendimi i kreditorit se debitori gjatë vitit 2022 ka paguar shumë prej EUR 2,000.00 në emër të borxhit sipas këtyre faturave nuk qëndron për faktin se pagesat janë kryer në emër të marrëdhënies tjera kontraktuale me Ymalko Kosova Sh.P.K dhe nuk mund të ndërlidhen me borxhin sipas faturave të lëshuara nga “Xella Kosova” Sh.P.K. Në fund, ka shtuar se ka skaduar afati kohor brenda së cilit mund të kërkohet përmbarimi, ku edhe sipas nenit 353, par. 1 të LMD-së është përcaktuar se cilat janë kërkesat të cilat parashkruhen pas tre viteve. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar, ashtu që urdhri përmbarimor të shfuqizohet. Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, konkretisht se faturat janë lëshuar nga “Xella Kosova” L.L.C dhe jo nga kreditori nuk qëndrojnë, pasi që kreditori ka ndryshuar emrin e shoqërisë nga “Xella Kosova” L.L.C në “Ymalko Kosova” Sh.P.K, ku kjo evidentohet edhe përmes ekstraktit nga ARBK si dhe vendimin e aksionarëve. Poashtu, lidhur me pretendimin se faturat janë parashkruar, një pretendim i tillë nuk qëndron pasi që kërkesat parashkruhen pas 5 vitesh, konform nenit 341 të LMD-së, duke qenë se debitori me datë 05.05.2022 ka bërë pagesë në shumë prej EUR 1,000.00 dhe me datë 08.07.2022 në shumë prej EUR 1,000.00, duke pranuar borxhin nga faturat, e që e ka ndaluar parashkrimin. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet në tërësi si i pa bazuar

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje “LPP”) dhe nenit 12, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet, ndërsa procedura përmbarimore të përfundojë në tërësi, për shkaqet si në vijim: Gjykata, ka shqyrtuar pretendimet e debitorit në raport me parashkrimin e kërkesës së kreditorit, dhe gjeti se detyrimet të cilat burojnë nga faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbarimor janë përfshirë në parashkrim, kjo në përputhje me nenin 355, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili përcakton se: “Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. 2. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”.

Andaj gjykata e shkallës së parë gjeti se prapësimi i debitorit gjen mbështetje në kuptim të nenit 71, paragrafi 1, pika 1.10 të LPP-së, i cili përcakton se: "...prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: 1.10. kërkesa nga dokumenti përmbarues është e mbrojtur me ndonjë statut të kufizimeve".

Mbi këtë bazë, gjykata gjeti se prapësimi i debitorit gjen mbështetje në kuptim të nenit 71, paragrafi 1, pika 1.10 të LPP-së, i cili përcakton se: "...prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: 1.10. kërkesa nga dokumenti përmbarues është e mbrojtur me ndonjë statut të kufizimeve". Meqenëse gjykata ka aprovuar prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, me të cilin përcaktohet se: "Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera", vendosi që procedura përmbarimore në këtë çështje të përfundohej.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar shkalla e parë duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumentet, përkatësisht fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm se në rastin konkret, debitori përmes nënshkrimit të konfirmimit të datës 21.01.2019, ka pranuar borxhin sipas faturave mbi të cilat është lejuar urdhri përmbarimor rrethanë kjo e cila në kuptim të nenit 368.1 të LMD-së, ka ndërprerë afatin e parashkrimit të borxhit. Megjithatë, sipas nenit 373.2 të LMD-së, me të cilin është përcaktuar se "Parashkrimi i ndërprerë me anë të pranimit (pohimit) nga ana e debitorit fillon të rrjedhë përsëri nga pranimi (pohimi)", rezulton se kërkesa e kreditorit është e parashkruar për shkak të kalimi të afatit tre vjeçar nga momenti i pohimit të borxhit, data 21.09.2019 kur është nënshkruar konfirmimi mbi borxhin, e deri në paraqitjen e propozimit për përmbarim të kreditorit, data 28.04.2023, kjo në kuptim të nenit 355 të LMD-së.

Tutje gjykata e shkallës së parë i vlerësoj pretendimet e kreditorit në raport me pagesat e realizuara nga ana e debitorit me anë të së cilave ka pretenduar se është ndërprerë afati i parashkrimit, mirëpo të njëjtat i gjeti si të pabazuara, ngase kreditori nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi përmes së cilës do të mund të arrihej në përfundim se afati i përshkrimit të detyrimit sipas faturave është ndërprerë në kuptim të nenit 368 të LMD-së, për shkak të pagesave të pjeshme të kryera në emër të faturave mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbarimor. Gjykata Komerciale, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës ku me dispozitën e nenit

29 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbaremi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është: Fatura. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbaremi po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me dokumentet të besueshme, pasi që e njëjta nuk është nënshkruar nga ana e debitorit dhe si të tilla nuk paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbaremit në kuptim të dispozitës së nenit 21 të LPP-së.

Gjykata Komerciale- dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbaremore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimin të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se kemi të bëjmë me parashkrim të faturave nga urdhëri përmbaremore P.nr. 201/23 të dt. 28.04.2023 në lartësi prej 9,192.56 €, Faturës nr. INV-18-1187, e datës 21.12.2018; Faturës nr. INV-18-1187, e datës 20.12.2018; Faturës nr. INV-18-1185, e datës 21.12.2018; Faturës nr. INV-19-0525, e datës 26.04.2019; Faturës nr. INV-19-0466, e datës 18.04.2019; Faturës nr. INV-19-1045, e datës 17.07.2019; Faturës nr. INV-19-1098, e datës 23.07.2019; Faturës nr. INV-19-1103, e datës 24.07.2019; Faturës nr. INV-19-1127, e datës 26.07.2019; Faturës nr. INV-19-1175, e datës 01.08.2019, Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga Neni 355 par.1 i LMD-së, i cili përcakton se *“Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri*

*(3) vite” dhe paragrafin 2 të këtij neni përcakton se “Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”*

Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përmbarimore organi përmbarues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbarimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përmbarues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbarues dhe/apo atij të besueshëm, me ç’rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv. Fakti se kreditori ka dorëzuar ekstraktin që janë faturat përmes këtij urdhëri përmbarimor është evidente, mirëpo këto faturime janë parashkruar sepse propozimi i kreditorit për përmbarim është parashtruar me datë 28.04.2023, ndërsa për secilën nga kërkesat e kreditorit sipas faturave të cekura më lart kanë kaluar më tepër se 3 (tre) vite nga koha e maturimit/arritjes për pagesë dhe në gjykatë nuk mundë të konsiderohet i rregullt dhe nuk nënkupton se mund të anashkalohen prerogativat ligjore të parapara me dispozitat e nenit 355 par.1 dhe par. 2 të LMD-së.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

**Dhoma e shkallës së dytë**

**K.DH.SH.II.nr.750/24, me datë 05.06.2024**

**Gjyqtarja,**

**Saranda Bogaj Sheremeti**